

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Vendimit për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratur me titull “**Vështrime dhe analizë mbi vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ndaj Incidentit të Korfuzit dhe konteksti kohor që solli ngrirjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar**”, të kandidatit Mr. Sc. Enio Ibro, Komisioni në përbërje: 1. Prof. Dr. Bujar Ahmedi, 2. Prof. Dr. Ebrar Ibraimi, 3. Prof. Dr. Bekim Maksuti, 4. Prof. Dr. Jusuf Zejneli, dhe Prof. Dr. Ylber Sela - mentor, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik i paraqet këtë

R A P O R T

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Të dhënat biografike të kandidatit:

Enio Ibro është lindur më 21/07/1992 në qytetin e Elbasanit, Republika e Shqipërisë, .Në Tiranë ai ka kryer shkollimin fillor dhe shkollimin e mesëm respektivisht në shkollën “ E Kuqe” dhe gjimnazin “Ismail Qemali”.

Studimet themelore i ka regjistruar në vitin 2010 në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës duke i përfunduar ato me rezultate të larta në vitin 2013. Më pas është regjistruar në ciklin e dytë të studimeve duke i përfunduar dhe fituar titullin Master Shkencor në vitin 2015.

Menjëherë pas përfundimit të studimeve kandidati ka filluar angazhimin si pedagog i jashtëm pranë Departamentit Penal në lëndën “E drejtë Penale, pjesa e posaçme” me titullar Prof. Dr. Altin Shegani.

Në janar të vitit 2017 z.Ibro punësohet pranë Drejtorisë Juridike në Rektoratin e Universitetit të Tiranës. Gjatë këtij viti ai kryen një specializim pranë Selwyn College në Universitetin e Cambridge në Angli.

Gjatë vitit 2018 kandidati ka ndjekur një semestër pranë Universitetit Harvard në SHBA duke marrë vlerësimin me 97 pikë, nota A, në lëndën Global Law, Global History.

Në vitin 2019 kandidati fiton bursën të plotë prej Ministrisë së Arsimit dhe vetë universitetit amerikan dhe ndjek studimet Master of Laws (LL.M) në Universitetin Berkeley në Kaliforni duke i përfunduar studimet në vitin 2020.

Prej vitit 2019 z. Enio Ibro është pedagog i brendshëm pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe prej vitit 2018 pedagog i ftuar pranë Akademisë së Policisë.

Studimet e doktoratës në programin studimor Historia e institucioneve dhe shteti i së drejtës, moduli Historia e shtetit i ka regjistruar në vitin akademik 2017/18 në Universitetin e Tetovës nën udhëheqjen e Prof. Dr. Ylber Sela, në temë: “**Vështrime dhe analizë mbi vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ndaj Incidentit të Korfuzit dhe konteksti kohor që solli ngrirjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar**”, të miratuar nga Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Juridik-Universiteti i Tetovës.

Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoratës kandidati Enio Ibro i ka kryer me sukses provimet e doktoraturës, konferencat doktorale, dhe obligimet tjera të parapara me Rregulloren për studimet e doktoraturës të Universitetit të Tetovës.

Publikimet shkencore:

- Ibro Enio, L'Albania nell' Unione europea tra tradizione e sviluppo della liberta religiosa, **Bononia University Press**, Italy, 2017, ISBN: 8869231925
- Ibro Enio, Transitional Justice in Kosovo after the war: The hardship it faces, **Berkeley Journal of International Law**, USA, 2020
- Ibro Enio, The Corfu Channel incident in the International Court of Justice, **Justicia**, North Macedonia, 2022
- Ibro Enio, Vlerësimi i fakteve të reja të prezantuara pas gjykimit në çështjen e Kanalit të Korfuzit, **International Journal of Social Sciences**, North Macedonia, 2022

Pjesëmarrjet dhe referimet në konferencat shkencore:

- Pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare “100 vjet drejtësi dhe doktrinë”^[1]_[SEP]
- Pjesëmarrës në Konferencën “Dita e të drejtës franceze”^[1]_[SEP]
- Pjesëmarrës në Konferencën “Tradita e ligjit dhe ligji në tranzicion”^[1]_[SEP]
- Pjesëmarrës dhe referues në Konferencën “Shqipëria në BE ndërmjet tradites dhe zhvillimit te lirise fetare”
- Pjesëmarrës në Konferencën me temë “Dimensionet e reja ne ligjin per privatesine”^[1]_[SEP]

- Pjesëmarrës në Konferencën me temë "Zhvillimet ligjore dhe institucionale në Shqipëri në kuader të angazhimeve të MSA-se.
- Pjesëmarrës në Konferencat "Law&Economics", Universiteti Berkeley, SHBA

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës:

Kandidati Mr. Sc. Enio Ibro që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës e këndeje, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoraturës. Ai me sukses ka realizuar tri konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar punime, artikuj shkencor në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

Analizë e punimit të doktoratës: "Vështrime dhe analizë mbi vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ndaj Incidentit të Korfuzit dhe konteksti kohor që solli ngrirjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar"

Ky disertacion i doktoraturës ka një ndarje të përgjithshme prej dy pjesësh, pjesa e parë teorike dhe pjesa e dytë empirike.

Disertacioni i doktoraturës është i strukturuar në katër kapituj dhe përfundimet, sipas çështjeve që trajtohen dhe metodologjisë së shfrytëzuar, duke ju përmbajtur udhëzuesit për shkrimin e disertacionit të doktoraturës të Universitetit të Tetovës.

Disertacioni i doktoraturës fillon më pjesën e hyrjes e cila merret me parashtrimin fushës së studimit, dhe me kriteret e rëndësishë të objektit të studimit. Gjithashtu trajton çështjen e marrë për studim, detyrën shkencore, informacionet e rëndësishme, strukturën e punimit dhe dobinë e rezultateve të tij.

Kapitulli i parë:

Këtë kapitull kandidati e ndërton duke prezantuar Kornizën Teorike të Studimit dhe parashtruar cili është interesi dhe rëndësia e këtij studimi për sa i përket fushës së jurisprudencës. Ai na

parashtron aspektet më të rëndësishme të çështjes, kontributet e studiuesve të ndryshëm si dhe objektivat e tezës së tij. Gjithashtu në këtë kapitull i kushtohet rëndësi përshkrimit të metodologjisë së përdorur në punimin e dizertacionit.

Kapitulli i dytë:

Në këtë kapitull kandidati pasqyron analizën kualitative të informacioneve më të rëndësishme dhe gjithashtu analizën kronologjike të ngjarjeve si në aspektin historik, juridik dhe në kontekstin diplomatik midis dy vendeve si përpara dhe pas incidentit. Përmes analizës ai evidenton objektin e mosmarrëveshjes ligjore duke iu referuar parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

Kapitulli i tretë:

Duke u ndalur në vendimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara gjithashtu në atë të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në kapitullin e tretë kandidati na ofron perspektivën ligjore të Çështjes së Kanalit të Korfuzit.

Kapitulli i katërt:

Në këtë kapitull kandidati i kushton vëmendje të veçantë parashtrimin të fakteve në lidhje me incidentin pas vendimit të dhënë nga gjykata. Duke i analizuar ato, ai synon t'i paraprijë konkluzioneve të studimit referuar temës së përzgjedhur.

Konkluzionet:

Ky seksion përfshin paraqitjen e sintezës së përfundimeve dhe gjetjeve të disertacionit si rezultat i analizës në kapituj pararendës duke u munduar të ofrojë një qasje sa më shteruese në trajtimin e kësaj çështje.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Disertacioni i doktoraturës me titull: **“Vështrime dhe analizë mbi vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ndaj Incidentit të Korfuzit dhe konteksti kohor që solli ngrirjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar”**, për t’iu adresuar objektit kërkimor të pasqyruar gjatë trajtimit pararendës shqyrton metodologji dhe metoda të cilat ndërveprojnë me njëra tjetrën. Duke qenë se objekti primar i këtij disertacioni është i kuadrit ligjor dhe i një çështje specifike si ajo e incidentit të Kanalit të Korfuzit, kandidati ka përdorur metodikë hibride.

Kandidati ndërthur teknikat e mbledhjes së informacionit dhe strategjinë në tërësi të punimit në funksion të arritjes së objektivit të tij. Strategjia kërkimore e dizertacionit, vëzhgon dhe shqyrton vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Çështjen e Kanalit të Korfuzit si dhe arsyetimin e vendimeve të saj për çështjen për të përcaktuar nëse dhënia e drejtësisë dhe meritave nga gjykata ishte e përshtatshme për zgjidhjen e konfliktit dhe ndikimin në marrëdhënien mes dy vendeve.

Në vijim të këtij objektiv, teza miraton një metodë krahasimore, ku është parë e përshtatshme, të shqyrtohen pretendimet e palëve në raport me faktet si dhe krahasimi i analizës së vendimit në raport me të drejtën e dhënë. Fusha e kërkimit në këtë tezë përfshin hulumtimin cilësor të një natyre doktrinare dhe krahasuese. Kërkimi cilësor në fokus të temës përfshin studimin interpretativ analitik të çështjes midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë dhe problemin e specifikuar të interpretimit jurisprudencial të vendimit si aspekt thelbësor për kuptimin dhe interpretimin që i është bërë çështjes në kete punim. Ky hulumtim fillon me një metodologji ‘kërkimore’ që analizon kontekstin historik dhe kronologjinë e çështjes duke u fokusuar në interpretimit bazë të studiuësve mbi çështjen. Në vijim metodologjia “doktrimore” e fokuson një pjesë të hulumtimit në analizimin e bazave ligjore nën të cilat Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dha vendimin dhe lidhjet logjike përmes shqyrtimit të fakteve, formulimin dhe interpretimin e palëve mbi ngjarjen, duke u referuar në literaturën ekzistuese.

Me këtë qasje kandidati i mundëson studimit të analizojë në mënyrë kritike kuptimet dhe implikimet ligjore dhe parimet juridike që i mbështesin ato në kuadër të studimit të çështjes. Dizertacioni përmes metodës analizuese dhe krahasimore, përdor faktet e njohura rreth çështjes dhe qëndrimet e palës britanike dhe shqiptare, si indicie për të vlerësuar përputhshmërinë e të drejtës së dhënë në raport me vendimin e marrë nga gjykata. Fokus i veçantë i studimit është analiza mbi implikimin e incidentit të Kanalit të Korfuzit dhe vendimit në marrëdhëniet midis dy vendeve në konflikt. Ky aspekt i hulumtimit përcakton nëse zgjidhja e dhënë nga gjykata ishte e përshtatshme për zgjidhjen e konfliktit dhe si shërbeu në një kontekst më të gjërë vlerësimi juridik i çështjes në marrëdhënien mes vendeve.

Kërkimi studimor analitik është përqëndruar në komentimin teknik dhe ekspozimin sistematik të kontekstit juridik të çështjes. Kjo qasje pëlqehet nga ana shkencore pasi fokusi i studimit është kryesisht vëzhgimi dhe analiza e konfliktit sipas perspektivës ligjore duke u bazuar në interpretimin e çështjeve kyçe si të konfliktit ashtu dhe vendimit. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet që edhe pse studimi ligjor, në këtë rast i vendimit gjyqësor, bazohet në logjikën e konkluzioneve; këto përfundime nuk janë një shkencë ekzakte. Përkundrazi ato formohen nga gjykimi, i cili mund të ndikohet nga faktorë të tjerë, të tilla si historia, kultura, politika dhe ekonomia.

Këto faktorë “ndërdisciplinorë”, që krijojnë konvergjenca në nivelin akademike të studimit përbëjnë interes tangencial në këtë dizertacion. Teza kësajsoj metodologjikisht nuk synon të jetë as e ngurtë dhe as kërkon të vendosë ndonjë kufizim për metodën kërkimore politiko-ligjore, përkundrazi qëllimi i saj kryesor është të sigurojë një ekzaminim të plotë dhe të thelluar të incidentit të Kanalit të Korfuzit dhe vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Në vijim, teza nuk përfshin argumentime ndërdisciplinore në aspektet e trajtuara të hulumtimit pasi kjo do të zgjeronte synimin e tezës përtej objektivave të asaj dhe do ta bënte të vështirë për tu mbrojtur. Përkundrazi, studimi është rigoroz për sa i takon metodologjisë së zgjedhur pasi përfshin një vëzhgim objektit, të dhëna cilësore dhe analizë të materialeve ligjore që

e kronologjisë të incidentit duke identifikuar dhe ekzaminuar, posaçërisht momentet thelbësore që kanë të bëjnë me kontekstualizimin e konfliktit. Këto përfshijnë trajtimin e temave të tilla: si u zhvillua kronologjikisht Incidenti i Kanalit të Korfuzit, si e trajtuan palët, dhe çfarë pasojash solli kjo mënyrë trajtimi në raport me përgjegjësitë ligjore që do diskutoheshin në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Ky disertacion ka patur qëllim vëzhgimin dhe analizën e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi Çështjen e Kanalit të Korfuzit. Gjatë dizertacionit është evidentuar dhe theksuar rëndësia e parimeve juridike të trajtuara në këtë mosmarrveshje dhe është analizuar perspektiva e gjykimit mbi Çështjen e Kanalit të Korfuzit. Ndër pyetjet e ngritura gjatë këtij disertacioni mund të veçojmë:

Cili është kuptimi ligjor i këtij konflikti dhe ku bazohen faktet që krijojnë dispozitat juridike në thelb? Cilat janë parimet themelore që formojnë rregullat e këtyre dispozitave? Cilat janë implikimet e vendimit në raport me vlerësimin e të drejtës dhe marrëdhënien mes palëve? Cili është ndikimi i provave të reja dhe a lind detyrimi për një rivlerësim të çështjes në kuadër të këtyre zbulimeve?

Lidhur me aspektet kryesore të vendimit në objektin e analizës së këtij dizertacioni veçojmë këto përfundime të kandidatit:

Me gjetjen fajtores të Shqipërisë, Gjykata shfaqti një vlerësim të nuancuar, pasi gjykimi dështoi të adresonte aspekte të rëndësishme për fajësinë, njëkohësisht duke mos zgjidhur shkakun kryesor të incidentit për të gjykuar se kush i kishte vendosur minat dhe si përcaktohej përgjegjësia e Shqipërisë në rastin e një përgjegjësie të ndarë apo bashkëpërgjegjësie. Gjatë studimit është ndalur të theksohen disa nga çështjet e trajtuara nga gjykata mbi të cilat ka pasur opinione kontraverse.

Duke përdorur si themelin e analizës rëndësinë juridike të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, fokusi është të thjeshtohet qasja duke u orientuar drejt çështjeve sfiduese që ky incident solli për ligjin ndërkombëtar. Çështjet etike dhe ndikimet e jashtme në nxjerrjen e konkluzioneve janë të pashmangshme në një analizë por pranimi dhe evidentimi i rolit të tyre në raport me metodologjinë qendrore nuk duhet të nënvlerësojë gjetjet e këtij dizertacioni ose të kufizojë meritat e tij akademike.

Si një gjykatë e posaçme, në të cilën çështjet e një rëndësie primare referohen për zgjidhje, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Çështjen e Kanalit të Korfuzit për sa është marrë në konsideratë vlerësojmë se ka gjetur fakte aq sa i nevojiten duke anashkaluar një vlerësim shterues të tyre.

Në përfundim të kësaj analize mund të gjykojmë se shqyrtimi i fakteve në vendimet mbi incidentin na jep indikacionin mbi boshllëqet e rëndësishme në marrjen në konsideratë të fakteve që mund të kishin ndryshuar çështjen. Në rastin e vlerësimit të Shqipërisë përgjegjëse vendimi u mor bazuar në supozimin dhe vlerësimin në lidhje me dijeninë e palës shqiptare duke anashkaluar peshën e faktit.

Nëse Gjykata synon të zhvillohet në një forcë vitale si pjesë e strukturave të Kombeve të Bashkuara, duke e konsideruar këtë supozim kryesor për misionin e saj, vëmendja ndaj burimeve për mbledhjen dhe vlerësimin e fakteve duhet të marrë një përparësi më të lartë. Në veçanti, mund të rekomandojmë se juridiksioni këshillimor i Gjykatës ofron hapësirë zgjerimi, pasi procedura këshillëdhënëse është mjet ideal për vlerësimin e fakteve në statutin aktual të Gjykatës.

Me përcaktimin e parimeve ligjore të përfshira në gjykim gjykata nuk bën një përcaktim të qartë në vlerësimin e saj mbi përdorimin e forcës; Vërtetësia e rezervave ndaj gjykimit mund të vlerësohet dhe mbi bazën e evidentimit të çështjes së përgjegjësisë juridike mbi incidentin dhe

parimin e përgjegjesisë kolektive në vlerësimin e fajësisë e sidomos mangësinë e një gjykimi të tillë në përcaktimin e kompensimit;

Rëndësia e mbrojtjes të së drejtës për barazi ligjore nga gjykata në një çështje si kjo kishte rëndësi të veçantë për vetë faktin se ishte gjykimi i parë i Gjykatës pas krijimit të saj dhe konteksti kohor politik mjaft i ndjeshëm me përfundimin e luftës.

Zbulimi i fakteve të reja të cilat vërtetojnë hapësirën në të cilën lundronte marina angleze apo dokumentet tashmë të deklasifikuara sjellin nevojën për rishikimin i incidentit nën një dosje të plotësuar e cila mund të çojë në konkluzione të ndryshme mbi fajësinë. Propozohet që angazhimi i palëve për të riadresuar çështjen sipas standardeve juridike për rivlerësim do të kontribonte në drejtësinë e dhënë;

Janë theksuar disa nga problemet procedurale për krijimin e mekanizmave të rigjyimit të mosmarrëveshjeve duke orientuar rivlerësimin drejt diplomacisë dhe marrëveshjes mes shteteve; Sugjerohet që përshtatshmëria e mjeteve juridike të kërkuara do të varet nga vullneti i shteteve për rivlerësimin si të përgjegjësive mbi ngjarjen ashtu dhe të marrëdhënieve midis vetë shteteve.

Ndërsa kjo listë nuk është shteruese, ajo jep një pamje të analizës që është ndërmarrë dhe tregon se puna ka dhënë disa konkluzione bazuar mbi analizën shteruese të informacionit në dispozicion.

Në ekspozimin e rëndësisë së kësaj çështje, përfundim kryesor juridiksional i çështjes i shërbeu gjykatës në përcaktimin e kuadrit ligjor të funksionimit të saj, sipas të cilit Këshilli i Sigurimit nuk mund të kërkojë që një shtet t'i paraqitet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë pa pëlqimin e palëve.

Në përfundim mund të vlerësohet se çështja dha një kontribut të rëndësishëm në përkufizimin dhe konceptin ligjor të 'ngushticave detare' duke sqaruar përcaktimin përmes vlerësimit të bërë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Çështjen e Kanalit të Korfuzit.

Duke konkluduar mbi rëndësinë e gjykimit në referimin që ai përcjell mbi vlerësimin e provave gjykojmë se, si në konsideratat e Këshillit të Sigurimit ashtu edhe në dëgjesat e Gjykatës Ndërkombëtare, ishte e nevojshme që provat të vlerësoheshin në mënyrë më të balancuar. Disbalanca e provave të paraqitura në Këshillin e Sigurisë ku pesha u vendos tërësisht në pretendimet dhe provat e paraqitura nga Mbretëria e Bashkuar në mbështetje të pretendimeve të saj mbi çështjen jep hapësirë për dyshim.

Mbi shqyrtimin e provave është e dyshimtë pesha që mund të kenë prova të tilla në ndikimin e vendimeve, si të Këshillit dhe të Gjykatës në raport me pretendimet e palës që paraqet provat. Është një fakt që shprehjet dhe votat e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit do të përfaqësojnë politikën e tyre kombëtare duke nuancuar politikisht vlerësimin e provave në vënd të shqyrtimit të provave në thelb.

ex turpi causa non oritur actio... From a dishonorable cause an action does not arise

Në përfundim përmbajtja e këtij studimit duhet të shikohet në dritën e citatit të mësipërm. Nga një veprim i padrejtë nuk mund të vijë një përfundim i drejtë, ndaj ky pohim mbart mbi vete prerogativën për të thënë se Çështja e Kanalot të Korfuzit vlen që sot, nga juristë të disiplinës së të Drejtës Ndërkombëtare, të shihen nën optikën e fakteve të reja.

Tërësia e fakteve të reja, që për nga natyra e tyre shpalosin një prapavijë politike tek pala angleze, tregon dhe njëherë se marrëdhëniet ndërkombëtare duhen parë në frymën e reciprocitetit, po pa anashkaluar edhe konceptin juridik të sovranitetit, i cili është një tipar themelor i themelit të entiteteve shtetërore krahas popullsisë dhe territorit.

Rëndësia e një veprimi të tillë në kuadër të balancimit historik të së drejtës ashtu dhe të gravitacionit mes diplomacisë së dy vendeve kthehet në një detyrë për të ardhmen.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:

Tema që trajton kandidati Mr. Sc. Enio Ibro në këtë disertacion doktorature, është delikate pasi incidenti solli ngrirjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së bashkuar për disa dekada. Kjo tezë doktrale synon të hulumtojë objektivitetin e vendimit të Gjykatës në lidhje me incidentin e Korfuzit dhe pasojat juridike e politike që ai vendim solli ndërmjet dy shteteve. Ky studim ka trajtuar gjithashtu fakte e prova të reja, ekzistenca e të cilave mund të kishin ndikuar në vendimin përfundimtar të dhënë nga Gjykata. Nëpërmjet analizës së detajuar dhe krahasuese, studimi e bën më të lehtë për lexuesin e gjërë të kuptuarit e kontekstit juridik dhe politik. Teoria e krahasuar e fushës është sidomos e rëndësishme për hetuar segmentet të cilat pak ose fare nuk janë trajtuar në studimet e deritashme, apo cilat pyetje të cilat kanë mbetur pa përgjigje. Në këtë disertacion të doktoraturës kandidati ka shfrytëzuar burime teorike, ligjore, politike si dhe fakte e prova të reja mbi problemin e hulumtimit, për të arritur në përfundime sa më të sakta e të vërteta në lidhje me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:

Tema e disertacionit të doktoraturës **“Vështrime dhe analizë mbi vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ndaj Incidentit të Korfuzit dhe konteksti kohor që solli ngrirjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar”** përfshin një studim të gjerë, por edhe specifik të koncepteve të aplikuara dhe gjykuara në lidhje me incidentin e Korfuzit.






Kandidati ka bërë përpjekje të nxisë reflektimin nëpërmjet analizës juridike, historike e diplomatike ku përmes argumentimit shterues krijon hapësirën e zhvillimit të ideve për disa nga problemet kryesore të kësaj teme. Prandaj, çështjet e ngritura në këtë disertacion janë një kontribut jo vetëm për sferën juridike, por edhe sfera të tjera të shkencave shoqërore. Si pasojë, edhe studiues

të tjerë të fushave të ndryshme mund të trajtojnë shumë çështje të veçanta që prek ky disertacion dhe ai mund t'i shërbejë hulumtimeve të tjera shkencore të studiuesve pasardhës në fushën juridike. Gjithashtu zbulimi i fakteve apo provave të reja do ngjallte interes të veçantë në ripërsëritjen edhe njëherë të këtij studimi.

Vlerësim dhe rekomandim:

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës **“Vështrime dhe analizë mbi vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ndaj Incidentit të Korfuzit dhe konteksti kohor që solli ngrirjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar”**, të kandidatit Mr. Sc. Enio Ibro, ka nderin që t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Bujar Ahmedi, Kryetar  _____ ;
2. Prof. Dr. Ebrar Ibraimi, anëtar  _____ ;
3. Prof. Dr. Bekim Maksuti, anëtar  _____ ;
4. Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar  _____ ;
5. Prof. Dr. Ylber Sela, mentor  _____ ;

Tetovë, 2022